

## ËNDËRROJ DHE HULUMTOJ TË GJEJ SA MË SHUMË NËPËR ARKIVA

**Intervistë: Robert Elsie**

Albanologu Robert Elsie u lindi në Vankuvër (Vancouver) të Kanadasë më 29 qershor 1950. Ndoqi Universitetin e Kolumbisë Britanike (University of British Columbia), ku mbaroi studimet e filologjisë klasike dhe të gjuhësisë më 1972. Po këtë vit erdhi në Evropë me një bursë për të studiuar. Vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Lirë të Berlinit Perëndimor (Freie Universität Berlin), në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta (Ecole Pratique des Hautes Etudes) në Paris, në Institutin e Dublinit për Studime të Larta (Dublin Institute for Advanced Studies) në Irlandë dhe në Universitetin e Bonit (Universität Bonn), ku mbrojtë doktoraten më 1978. Që nga viti 1978 vizitoi Shqipërinë disa herë në kuadrin e takimeve shkencore midis Institutit të Gjuhësisë së Universitetit të Bonit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Gjithashtu, mori pjesë disa vjet me radhë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Kosovë. Pas studimeve universitare punoi për Ministrinë e Punëve të Jashtme Gjermane në Bon. Është anëtar i Shoqatës së Evropës Juglindore (Südosteuropa-Gesellschaft), anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton në një fshat malor të Gjermanisë afër kufirit belg.

Është me rëndësi të ceket se Elsie është edhe botues i shumë librave, publikimeve dhe i recensioneve. Është një ndër albanologët më produktivë.

*Zoti Elsie, dihet se populli shqiptar pas vetes ka një histori të rëndë. Mu për shkak të kësaj edhe letërsia edhe kultura edhe gjuha sot kanë mjaft probleme të natyrës historike. Mendoni se historia, letërsia shqiptare dhe të shkruarit shqip e pësoi fatin e popullit apo edhe më keq?*

Elsie: Po, mund të thuhet që letërsia ka pësuar fatin e popullit të vet dhe është e qartë që fati i popullit shqiptar është i dhimbshëm gjatë gjithë kohës së zhvillimit të tij. Në historinë e shqiptarëve ka pasur disa prerje dhe këto prerje janë pasqyruar edhe në letërsinë shqiptare. Kështu kemi një pjesë të letërsisë shqiptare me autorët e krishterë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë-shtatëmbëdhjetë. Ky ishte një fillim i mirë për letërsinë shqiptare, por me ndryshimet politike apo, më konkretisht, me ardhjen e pushtimit turk në Shqipëri dhe me islamizmin e shqiptarëve, kjo letërsi mbaroi. Unë në librin tim 'HISTORI E LETËRSISË SHQIPTARE', e kam krahasuar letërsinë shqiptare me një bimë që rritet me lule, që lulezon, por që rrënjët e saj janë prerë disa herë, kështu që detyrimisht duhej të fillonte nga zeroja. Shkaktar i kësaj është ardhja e Perandorisë Osmane, ngase më ardhjen e saj, rrënjët e letërsisë u këputën. Pas pak kohe më ngadalë erdhi një letërsi tjetër, në letërsi me frymë orientale. Letërsia e bejtexhinjve nuk është një letërsi aq e fortë, por është një kapitull mjaft interesant i letërsisë shqiptare. Pas kësaj prapë ka një ndërprerje në shekullin XIX, kur shqiptarët panë se e ardhmja e tyre është në Perëndim e jo në Lindje dhe u larguan nga traditat lindore, p.sh. nga shkronjat arabe dhe iu drejtuan Perëndimit me një alfabet të ri, apo me disa alfabete në atë kohë dhe me një frymë me shumë kombëtare sesa fetare. Kjo ishte pak a shumë letërsia e tretë shqiptare. Kjo letërsi kombëtare vazhdoi deri në Luftën e Dytë Botërore. Këtu prapë ka një prerje shumë të fortë. Me ardhjen e komunistëve në pushtet në Shqipëri, letërsia e tretë gati u shkatërrua. Autorët u burgosën, u vranë, ikën në mërgim dhe kështu u krijua prapë pas Luftës së Dytë Botërore një letërsi e katërt, një letërsi me frymë të lëvizjes socialiste e që vazhdoi deri në fund të diktaturës në Shqipëri. Edhe vitet 1990-1991 filluan me një periudhë të re për letërsinë shqiptare. Kështu, ka disa prerje ose goditje në historinë e shqiptarëve dhe në historinë e letërsisë shqiptare.

*Ju na i dhatë ca shembuj të zhvillimit të letërsisë në Shqipëri, gjithashtu edhe etapat e zhvillimit të letërsisë dhe krijesit shqiptarë. Si do ta shpjegoni ju situatën e krijesit në Kosovë?*

Elsie: Rritja e letërsisë në Kosovë ka qenë akoma më e vështirë. Vetë fakti që për një letërsi në Kosovë mund të flasim vetëm nga vitet e 60-të, tregon që në Kosovë ka qenë e pamundur të zhvillohet një kulturë letrare. Arsyet politike janë të njohura: pushtimi osman dhe pastaj pushtimi serb, që ishin, pak a shumë, të njëjta për sa u përket aspiratave të kulturës letrare të shqiptarëve. Letërsia filloi të zhvillohet shumë vonë dhe ka lulëzuar përnjëherë. Unë mendoj që periudha kryesore e letërsisë shqipe në Kosovë ka filluar në vitet e shtatëdhjeta apo, ndoshta, në ato të tetëdhjeta. Pastaj edhe kjo u kthye prapë me terrorin nga Beogradi e që pasojat janë të njohura. Tradita e krijesve në Kosovë është krejt ndryshe nga tradita e krijesve në Shqipëri. Në njërin anë kishte më shumë liri intelektuale, por në Shqipëri nuk kishte kurrfarë lirie. Nuk mund të hyj në detaje, sepse është detyrë e krijesve, që vetë të tregojnë si e shohin zhvillimin e letërsisë, por megjithatë në kuadër të Jugosllavisë liri totale si në Perëndim, për shembull, nuk ka patur.

Fati i shkrimtarit këtu në Kosovë, mjerisht, ka qenë sikur edhe fati i të gjithë popullit. Nuk besoj që ka një familje shqiptare në Kosovë që nuk ka pësuar ndonjë traumë. Unë për shembull këtu takova një krijues, të cilit i dogjën tërë bibliotekën. Shumë u arrestuan, u keqtrajtuat, në mënyrë të veçantë ndoshta intelektualët, sepse ata ishin të rrezikshëm për pushtetin serb. Intelektualët ishin ata që kërcënonin pushtetin serb.

Por, une duhet të them një gjë: gjatë tërë asaj kohe mua më ka habitur qetësia e intelektualëve shqiptarë, përkatësisht, vendosmëria e tyre e qetë për të ecur përpara, për të mos u shkatërruar tërësisht nga regjimi serb. Intelektualët ishin të përndjekur, por megjithatë kanë vazhduar rrugën më me siguri, hap pas hapi. Për këtë arsye unë kam një admirim për gjithë këta njerëz, që kanë vazhduar të botojnë libra, që kanë vazhduar edhe hulumtimet edhe të parrogë me muaj të tërë e madje edhe me vite të tëra. Kur e shoh sesi janë trajtuar anëtarët e Institutit Albanologjik gjatë dhjetë vjetëve të fundit, apo edhe mësuesit shqiptarë të Kosovës, që kanë qenë të papaguar, por megjithatë kanë vazhduar punën krijuese, kjo më bën të kem për ta admirim të plotë.

*Z. Elsie, flitet shumë për letrat dhe dokumentet e vjetra të shkruara në gjuhën shqipe. Dihet se gjatë shekujve shqiptarëve secili pushtues gjithnjë ua mohonte të drejtën e të shkruarit në gjuhën e tyre. Madje, pushtuesit osmanë ishin aq të egër, sa dignin çdo gjë që ishte e shkruar në gjuhën shqipe. Çka mendoni për dokumentet dhe letrat e vjetra shqipe të shek. XII, të përmendura edhe nga ju?*

Elsie: Po, flitet shumë, por njerëzit nuk dallojnë midis ëndrrave dhe realitetit, d.m.th. kanë dëshirë që të zbulojnë dokumentet e vjetra dhe vazhdimisht flitet për lashtësinë e kulturës shqiptare, për lashtësinë e popullit shqiptar, për lashtësinë e gjuhës shqipe, por, fatkeqësisht, ne nuk dimë asgjë. E vërteta është se nuk janë gjetur burime kryesore të letërsisë shqiptare para Buzukut. Janë zbuluar disa tekste, por nuk besoj se do të gjejmë një tekst para shekullit XIV. Megjithatë unë kam shpresë, edhe unë i kam ëndrrat e mia dhe vazhdimisht kërkoj nëpër arkiva të ndryshëm, Në vitin e kaluar janë gjetur disa shkrime të cilat janë botuar në revistën “*Eksklusive*,” tekste mjaft interesante dhe kjo dëshmon se mund të ketë diçka, por do të ishte mrekulli poqëse gjejmë diçka para Buzukut.

*Siç dihet, ju jeni edhe autor i një historie të letërsisë shqiptare. A mund të na thoni sesi u prit ky libër nga lexuesi joshqipfolës?*

Elsie: Po, ky libër ishte dhënë si histori e letërsisë shqiptare së pari në anglisht e jo në shqip me qëllim të nxitjes së interesimit, sepse nuk ka shumë njohuri për kulturën shqiptare në botën e jashtme. Pra, mungojnë librat, mungojne informacionet dhe qëllimi im ishte që me këtë libër të hidhja themelet e njohurive në botën e jashtme.

Njohuritë për letërsinë shqiptare në botë janë tepër të kufizuara. Në France janë botuar shumë libra në përkthim dhe pastaj më pak në anglisht, gjermanisht, italisht apo në ndonjë gjuhë tjetër. Në përgjithësi mund të them që njohuritë janë tepër të kufizuara. Në gjuhën angleze para këtij librit tim u botua një histori e shkurtër e letërsisë shqiptare nga Stuart Man dhe pikërisht për këtë kam ndërmend të flas në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën Shqipe, që do të mbahet në Prishtinë. Nuk mund të them që ka një interesim të madh për letrat shqiptare, apo për kulturën shqiptare në përgjithësi, por, në anën tjetër, lirisht mund të them se ky interesim po rritet, sepse për herë të parë shqiptarët shihen në botën e jashtme. Para dhjetë vjetëve, për shembull, asnjëri nuk dinte ku ishin shqiptarët. Shqiptarët në Shqipëri ishin të mbyllur prapa mureve të tyre, ndërsa shqiptarët e Kosovës ishin të mbyllur nga jugosllavët, përkatësisht, nga serbët. Por, me rënien e diktaturës në Shqipëri, me emigracionin masiv të shqiptarëve dhe problemet që lidhen me të, shqiptarët janë bërë të njohur në botë e akoma më shumë janë bërë të njohur me luftën për çlirimin e Kosovës. Kështu, kam shpresë se kjo do të ndikojë që edhe kultura shqiptare të bëhet edhe më e njohur.

*Si njohës i mirë i letërsisë shqiptare, si do ta komentoni Ju situatën e letërsisë së arbëreshëve të Italisë dhe të arvanitasve në Greqi?*

Elsie: Ne e dimë që sot ne nuk mund të flasim për një letërsi arvanitase apo shqiptare në Greqi, ngase në kushte të sotme atje, një arvanitas nuk mund të krijojë fare. Politika e pakicave nuk është aftësia për të cilën shkëlqejnë grekët. Është e njohur. Grekët udhëheqin një politikë shumë të dobët kur është fjala për minoritetet. Ata edhe nuk mund të pranojnë ekzistencën e pakicave kombëtare. Ata flasin vazhdimisht për barazinë dhe të drejtat në Ballkan, por në vendin e vetë nuk pranojnë kurrfarë minoriteti. Kjo është e qartë. Gjatë shekujve ku shqiptarët apo arvanitasit kanë jetuar në Greqi, nuk kanë pasur mundësi të krijojnë, sepse çdo gjë ishte nën mbikqyrjen e kishës ortodokse, e cila nuk duronte gjuhë tjetër pos greqishtes. Sot ata janë gati të asimiluar. Traditat letrare të cilat i kanë pasur dhe traditat gjuhësore, gati do të jenë zhdukur. Kjo është gjendja.

*Si do ta vlerësonit ju zgjidhjen më të mirë të problemit të Kosovës në transicion, zgjidhje kjo që do t'i hapte mundësinë studiuesit për studim dhe krijim në mënyrë që ai ti dhurojë diçka shkencës, kulturës, artit etj., kur dihet se edhe sot studiuesi dhe krijuesi nuk paguhet aq sa e meriton?*

Elsie: Çdo gjë varet prej financës. Kosova ka shumë probleme urgjente dhe është e qartë se kur ka shumë probleme, pak vend mund t'i jepet kulturës, artit etj. Megjithatë kosovarët, në krahasim për shembull me shqiptarët në Shqipëri, janë të interesuar shumë për kulturën e vetë.

intervistoi: BLERIM CANAJ

[botuar në: *Eksklusive, mujore për aktualitet, kulturë, shkencë, sport*, Nr 21, janar 2002, f. 94-95.]